



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 8, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.6, neni 14, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L—185);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_295_010_09**;
- Ankesa e konsumatorit e datës 15.08.2014.

në seancën e mbajtur më datë 29 gusht 2014, nxorri këtë:

V E N D I M

- I REFUZOHET** ankesa e konsumatorit A. G. me shifër DPR 24515 nga Prishtina ndaj vendimit të DMK-së.
- II MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. ZRRE/DMK_V_295_10_09 i datës 20.10.2009.

Arsyetim

Me datë 07.10.2008, zyrtarët e autorizuar të KEK-ut për ndërrimin e njehsorit elektrik në mbështetje të kërkesës së konsumatorit të datës 03.10.2008, kanë larguar nga matja e konsumit të energjisë elektrike njehsorin elektrik me nr. 4525379 dhe kanë vendosur për matje të konsumit të energjisë elektrike njehsorin elektrik me nr. 45275368€. Pas ndërrimit të njehsorit elektrik punëtorët e autorizuar të kalibrimit me datë 05.12.2008 kanë bërë kontrollimin njehsorit elektrik nr. 4525379, ku është konstatuar se: pjesa kyçëse nga ana e jashtme e njehsorit është e djegur, rreth qelqit nga ana e majtë është futur shiriti filmik si dhe në brendi të njehsorit ka pluhur dhe copa të shiritit filmik.

Pas konstatimit të punëtorëve të qendrës së kalibrimit, punëtorët e autorizuar të kontrollës së KEK-ut me datë 22.01.2009 kanë dalur te konsumatori dhe kanë bërë regjistrimin e të dhënave teknike të pikës matëse. Me datë 16.03.2009 KEK-u e ka ngarkuar konsumatorin me ngarkesë për shfrytëzim të paautorizuar (rikthim i humbjeve) me anë të faturës DPR09HP07419 në vlerë prej 890.88 €

Me datë 19.03.2009 konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për konsumator në KEK duke kundërshtuar ngarkesën për shfrytëzim të paautorizuar. Pas kësaj anekese Departamenti për Konsumator në KEDS me datë 16.12.2013 i është përgjigjur ankesës së konsumatorit duke e refuzuar ankesën e konsumatorit.

Konsumatori pas marrjes së përgjigjes së KEDS-it ka parashtruar ankesë në Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE duke kontestuar faturën e muajit shtator 2013. DMK pas parashtrimit të ankesës së konsumatorit ka bërë shqyrtimin e ankesës dhe me datë 20.10.2009 ka nxjerr vendim duke e refuzuar pjesërisht ankesën e konsumatorit dhe duke kërkuar nga KEK-u që të



rikalkuloj faturën e shfrytëzimit të paautorizuar DPR09HP07550 në vlerë prej 696 €, vlera financiare e mbetur 195€ prej faturës DPR09HP07419 duhet të korrigohet

Baza e kundërshtimit të konsumatorit të theksuara në ankesë është se kundërshton vendimin e DMK-së. Konsumatori në ankesën e tij ka theksuar se menjëherë pas shitblerje së pronës nga Rr. G. një person i quajtur H. F. e ka uzurpuar atë dhe këtë uzurpim e kemi kundërshtuar në gjykatë dhe se më 07.09.2000 gjykata ka nxjerr vendim për lirim të pronës, i cili vendim është ekzekutuar me datë 23.03.2001. Pas kësaj jemi detyruar edhe borxhin e tij ta paguajmë. Në vitin 2008 pronari ka filluar renovimin e katit përdhësë të shtëpisë i cili ka qenë i demoluar nga uzurpatori, dhe se me të filluar renovimi konsumatori ka lajmëruar KEK-un dhe ka kërkuar ndërrim njehsori. KEK-u ka theksuar se ndërrimin duhet ta bëni ju, dhe tek pas një muaji kanë ardhur dhe e kanë marrë njehsorin e vjetër pa asnjë vërejtje. Pas kësaj ka ardhur dënimi prej 900€ për shkak të dëmtimit të njehsorit. Konsumatori thekson se nuk është duke e kontestuar vlerësimin e ekspertëve por që prindi i blerës ka trashëguar njehsorin nga shitësi dhe aty ka pasur edhe uzurpator. KEK-u është dashur që me ndërrimin e pronarit të ndërrohet edhe njehsori elektrik e jo që pastaj pas disa viteve të na dënoj. Në procesin e ndërrimit të njehsorit elektrik nuk ka pasur asnjë vërejtje nga ana KEK-ut, si dhe para ndërrimit njehsori është nxehur shumë por KEK-u ka theksuar se është në rregull. Konsumatori në fund të ankesës ka theksuar se kërkon nga Bordi i ZRRE-së që vendimin e ZRRE-së ta ndryshoj në pikëpamje të vendimit mbi dënimin aq shumë të lartë dhe të paarsyeshëm.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 29 gusht 2014 ka analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga ana e konsumatorit, dhe pas vlerësimit të gjitha këtyre shkresave ka vërejtur se DMK, ka vepruar konform dispozitave ligjore në fuqi me rastin e marrjes së këtij vendimi. Bordi i ZRRE-së ka konstatuar punëtorët e autorizuar për kontrollimin e njehsorëve elektrik në laboratorin e qendrës së kalibrimit i kanë ofruar dëshmi ZRRE-së të cilat tregojnë se rreth qelqit nga ana e majtë në njehsorin elektrikë me nr 4525379 është futur shiriti filmik dhe se në brendi të njehsorit ka pluhur dhe copa të shiritit filmik. Nga provat e ofruara prej Laboratorit të Qendrës së Kalibrimit në KEK sh.a (fotografit e qendrës së kalibrimit) vërtetohet se në brendësi të njehsorit elektrik ka pluhur dhe copa të shiritit filmik. Kjo të qon në konstatimin se ky dëmtim ka ardhur si pasojë e përpjekjes së konsumatorit për te vendosur në anën e majtë te qelqit shirit filmi me qëllim të pengimit të punës së diskut të njehsorit elektrikë.

Bordi i ZRRE-së gjatë shqyrtimit të dokumentacionit thekson se konsumatori nuk ka ofruar arsyetim të dëshmuar për mënyrën dhe periudhën e dëmtimit të njehsorit elektrik.

Bordi i ZRRE-së ka vlerësuar se konsumatori në ankesën e tij nuk ka prezantuar asnjë provë të vetme me të cilën e vërteton faktin se vendimi i DMK-së nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligj, andaj si të tilla nuk paraqesin bazë të mjaftueshme për prishjen e këtij vendimi.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 29.08.2014 ka analizuar ankesën e konsumatorit dhe vendimin e nxjerr nga DMK nr. ZRRE/DMK_V_295_10_09, dhe pas analizimit të hollësishëm të të gjitha dëshmimeve tjera të prezantuara në shkresat e lëndës ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.

IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimin të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së

Enver Halimi, kryesues

Merita Kostari, anëtare

Krenar Bujupi, anëtar